

No. 53487*

**Belgium
and
Albania**

**Agreement on social security between the Kingdom of Belgium and the Republic of Albania.
Brussels, 9 December 2013**

Entry into force: *1 January 2016, in accordance with article 47*

Authentic texts: *Albanian, Dutch, English and French*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Belgium, 18 February 2016*

**No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

**Belgique
et
Albanie**

**Convention sur la sécurité sociale entre le Royaume de Belgique et la République d'Albanie.
Bruxelles, 9 décembre 2013**

Entrée en vigueur : *1^{er} janvier 2016, conformément à l'article 47*

Textes authentiques : *albanais, néerlandais, anglais et français*

Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies : *Belgique, 18 février 2016*

**Aucun numéro de volume n'a encore été attribué à ce dossier. Les textes disponibles qui sont reproduits ci-dessous sont les textes originaux de l'accord ou de l'action tels que soumis pour enregistrement. Par souci de clarté, leurs pages ont été numérotées. Les traductions qui accompagnent ces textes ne sont pas définitives et sont fournies uniquement à titre d'information.*

[ALBANIAN TEXT – TEXTE ALBANAIS]

MARRËVESHJE

PËR

MBROJTJEN SOCIALE

NDËRMJET

MBRETËRISË SË BELGJIKËS

DHE

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**MARRËVESHJE
PËR
MBROJTJEN SOCIALE
NDËRMJET
MBRETËRISË SË BELGJIKËS
DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

MBRETËRIA E BELGJIKËS

DHE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË,

DUKE DËSHIRUAR që të rregullojnë marrëdhëniet reciproke midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes sociale,

VENDOSËN që të nënshkruajnë një Marrëveshje për këtë qëllim dhe ranë dakord si më poshtë:

PJESA I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje:
 - a) Termi “Belgjikë” ka kuptimin: Mbretëria e Belgjikës;
Termi “Shqipëri” ka kuptimin: Republika e Shqipërisë.
 - b) Termi “territor” ka kuptimin:
 - për sa i përket Belgjikës: territori i Mbretërisë së Belgjikës;
 - për sa i përket Shqipërisë: territori i Republikës së Shqipërisë.
 - c) Termi “Legjislacioni” ka kuptimin: ligjet dhe rregulloret lidhur me mbrojtjen sociale të përcaktuara në Nenin 2.
 - d) Termi “autoritet kompetent” nënkupton: Ministrat, secili në atë masë që ai është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të specifikuar në Nenin 2.
 - e) Termi “Agjenci” ka kuptimin: institucion, organizatë ose autoritet përgjegjës në tërësi apo pjesërisht për zbatimin e legjislacionit të specifikuar në Paragrafin 1 të Nenit 2.
 - f) Termi “Agjenci kompetente” ka kuptimin: agjencia që është financiarisht përgjegjëse për përfitimet.
 - g) Termi “periudhë sigurimi” ka kuptimin:
 - për sa i përket Belgjikës: çdo periudhë e njohur si e tillë në legjislacionin Belg, në bazë të së cilit është plotësuar kjo periudhë, si dhe çdo periudhë e njohur në bazë të këtij legjislacioni si ekuivalente e një periudhe sigurimi;
 - për sa i përket Shqipërisë: çdo periudhë kontributi, pune, veprimtarie profesionale dhe çdo periudhë e njohur në bazë të legjislacionit Shqiptar si ekuivalente e një periudhe sigurimi.
 - h) Termi “përfitim” nënkupton: çdo pension, çdo përfitim në natyrë apo në para të parashikuar nga legjislacioni i secilit prej Shteteve Kontraktuese, duke përfshirë çdo shtesë ose të rritje në fuqi sipas legjislacionit të specifikuar në Nenin 2.
 - i) Termi “anëtar i familjes” do të thotë: çdo person i përcaktuar ose i njohur si një anëtar i familjes ose i caktuar si anëtar i familjes nga legjislacioni, në bazë të së cilit jepen përfitimet, ose në rastin e parashikuar në Nenin 14, nga legjislacioni i Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit banon një person i tillë.
 - j) Termi “vendbanim,” do të thotë: vendi ku një person banon zakonisht.
 - k) Termi “qëndrim” nënkupton: qëndrim i përkohshëm.

2. Çdo term që nuk është përkufizuar në Paragrafin 1 të këtij Neni ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 2 Objekti Ligjor

1. Kjo Marrëveshje zbatohet:

- a) Për sa i përket Belgjikës ndaj legjislacionit në lidhje me:

- (i) Përfitimet për sëmundje dhe e barrëlindje, në natyrë ose në para për personat e punësuar, detarët e marinës tregtare dhe personat e vetëpunësuar;
- (ii) Përfitimet për sa i përket aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- (iii) Pensionet e pleqërisë dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar;
- (iv) Përfitimet e invaliditetit për personat e punësuar, detarët e marinës tregtare dhe personat e vetëpunësuar;

Dhe, për sa i përket Pjesës II vetëm, ndaj legjislacionit në lidhje me:

- (v) Mbrojtjen sociale për personat e punësuar;
- (vi) Mbrojtjen sociale të të vetë-punësuarve.

- b) Sa i përket Shqipërisë, ndaj të gjithë legjislacionit në lidhje me:

- i) Skemën e mbrojtjes sociale:

- përfitime të sëmundjes në para për personat e punësuar;
- përfitimet e barrëlindjes në para për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;
- përfitimet në para në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;
- pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

- ii) Sipas Skemës së Detyrueshme të Sigurimeve Shëndetësore, nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore përfitojnë kategoritë e mëposhtme:

- a) personat e punësuar;
- b) individët e vetëpunësuar;
- c) punonjësit e papaguar të familjes;
- d) persona të tjerë ekonomikisht aktive;
- e) persona që marrin përfitime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- f) personat që marrin ndihmë sociale apo pagesë paafëties, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- g) personat e regjistruar si punëkërkuar të papunë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- h) azilkërkuarët e huaj në Republikën e Shqipërisë;
- i) fëmijët nën moshën 18 vjeç;
- j) nxënësit dhe studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga aktivitetet ekonomike;
- k) kategoritë e individëve të përcaktuara me ligje të veçanta;
- l) personat që janë siguruar vullnetarisht.